



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTJIA  
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT  
REPUBLIKA KOSOVO – PRESEDNICA



<b>Për:</b>	Zyra e Rregullatorit për Energji - ZRRE
<b>Nga:</b>	Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës - ZPRK
<b>Tema:</b>	Komente nga Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës ndërlidhur me procesin e shqyrtimit të jashtëzakonshëm për të Hyrat e Lejuara Maksimale për Operatorët e Rregulluar
<b>Data:</b>	3 mars 2023

Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës ndjek më vëmendje të shtuar zhvillimet në sektorin e energjisë në vend, duke qenë se është sektor strategjikisht i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik e në veçanti për faktin se ka ndikim të drejtpërdrejt edhe në mirëqenien e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Përgjatë vitit 2022, si rezultat i rritjes së çmimeve të energjisë elektrike në bursat energjetike në Evropë, kombinuar me situatën jo të favorshme sa i përket gjenerimit të energjisë elektrike në vend si pasojë e varësisë në dy termocentrale jashtëzakonisht të vjetruara, si dhe mungesën e prodhimit të mjaftueshëm vendor për mbulimin e nevojave të konsumit, janë paraqitur sfida të vazhdueshme në drejtim të garantimit të sigurisë së furnizimit.

Rikujtojmë se pas hapjes së rrugës për shqyrtim të jashtëzakonshëm tarifor në fund të vitit 2021, procesi u përmbyll në shkurt të vitit 2022, me vendimin për të Hyrat e Lejuara Maksimale për FSHU-në, Vendimi nr. V\_1486\_2022 të dt. 7 shkurt 2022, i cili rezultoi me rritje të tarifave.

Si rezultat, konsumatorët e tarifës mbi 800 kilovat për orë do t'i nënshtroheshin tarifës së lartë prej 12.5 cent për kilovat dhe 5.9 cent për tarifën e ulët. Ndërsa, konsumatorët që shpenzojnë deri në 800 kilovat në orë në muaj, do t'i nënshtroheshin tarifës së lartë prej 7 cent dhe tarifës së ulët në shumë prej 3 cent.

Kjo rritje e tarifave parashihej të mos ndikonte tek konsumatorët që do të shpenzonin deri në 800 kilovat në orë për shkak të subvencionimit nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Nga rritja e tarifave u kursyen edhe bizneset që janë në tregun e rregulluar. Përkundër kësaj, rritja e tarifave përgjithësisht paraqiti një sfidë serioze për qytetarët tanë.

Paralel me këto zhvillime, u shtuan përpjekjet e institucioneve të Kosovës, por edhe të vetë qytetarëve për avancim dhe investime serioze në masa të efijencës së energjisë. Si rezultat i kësaj, nga Ministria e Ekonomisë raportohet se gjatë muajve të dimrit niveli i kursimit ka shkuar prej 4 - 15%, gjë që nënkupton edhe reduktim të nevojës për gjenerim apo importim të energjisë.

Përkundër rritjes së tarifave në vitin 2022 në shqyrtimin e jashtëzakonshëm, operatorët e rregullar kanë argumentuar se si rezultat i kostove më të larta aktuale sesa ato të njohura në tarifa dhe mungesës së ndarjes së subvencionit të plot nga Qeveria e Republikës së Kosovës, por edhe si pasojë e inflacionit dhe rritjes së kostove operative brenda vitit financiar, ka lindur sërish nevoja për kërkesë për shqyrtim të jashtëzakonshëm të të hyrave të lejuara maksimale.

Nisur nga kjo, sipas vlerësimeve preliminare nga ana e ZRRE-së, vlerësohet se mund të pritët një rritje e tarifave prej 14%.

Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës shpreh shqetësimin për ndikimin eventual socio-ekonomik të një vendimi të tillë dhe për barrën që një vendim i tillë do t'i shkaktonte qytetarëve e në veçanti grupeve më të cënueshme të shoqërisë, si pensionistët, nënat vetushqyese, mbajtësit e skemave sociale dhe njerëzit dhe familjet e marginalizuara.

Një situatë e tillë bëhet ende më shqetësuese për faktin se në bazë të raportit të ASK-së për vitin 2022, krahasuar me vitin 2021, norma vjetore e inflacionit në dhjetor ishte 12.1 për qind. Gjersa, inflacioni mujor i matur nga indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit ishte 0.9%, gjë që ka ndikuar në rritjen e kostos së përgjithshme të jetesës dhe varfërim të shportës së konsumatorit.

Duke i konsideruar rrethanat e cekura më lartë, ZPRK-ja rekomandon që në këtë shqyrtim të jashtëzakonshëm tarifor të vlerësohen mundësitë për shmangie të rritjes së tarifave duke inkurajuar komunikimin dhe koordinimin ndërinstytucional me qëllim të sigurimit të subvencionimit të kostove shtesë të cilat kanë ndikuar në rritjen e vështirësive për operatorët e rregulluar.

Në këtë drejtim do të mund të kontribuonte edhe pakoja e Mbështetjes për Energji e BE-së për Kosovën përmes së cilës janë siguruar 75 milionë euro për të ndihmuar me përballjen me krizën energjetike. Sipas marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe BE-së, 25 milionë euro do të shkojnë për subvencionimin e faturave të energjisë dhe metodave të ngrohjes alternative, si druri dhe peleti.

Andaj, ZPRK-ja, rekomandon që përpara marrjes së një vendimi final, të shqyrtohet seriozisht mundësia e subvencionimit, duke shmangur nevojën për një vendim të ri të ZRRE-së, i cili do të rezultonte me rritje të sërishme të tarifave në vendin tonë.

Në veçanti, potencojmë rëndësinë e shmangies së një vendimi të tillë nga ZRRE-ja, duke qenë se bazuar në praktikën nga e kaluara, pas vendimeve të marra në procese për shqyrtim të jashtëzakonshëm të tarifave nuk është bërë asnjëherë një rivlerësim pasues, i cili eventualisht do të ndikonte në rikthimin e tarifave origjinale të vlefshme para rritjes në rast të rehabilitimit të faktorëve të cilët fillimisht kanë shkaktuar nevojën për shqyrtim të jashtëzakonshëm.

ZPRK-ja respekton në plotni pavarësinë e ZRRE-së, mirëpo inkurajon që procesi të finalizohet duke pas konsideratë të plotë për situatën socio-ekonomike në vend, gjithnjë duke mos e rrezikuar stabilitetin, sigurinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit energjetik.